

Interesat janë të pranishëm që me lindjen e foshnjave dhe aktivizohen prej vlerësimit të rrisë të konstatuar tek një ngjarje, objekt, etj.

Fëmijët interesohen për gjërat, objektet, ndjesitë që janë plot ngjyra, që janë të lëvizshme, ritmike, harmonike, e në përgjithsi shumë të bukura.

Foshnjat tregojnë interes për fytyrën e nënës, sidomos për sytë e saj dhe fëmijët e vegjël janë syçelur në kuriozitetin dhe interesin për jetën e prindërve të tyre.

Prindërit duhet të inkurajojnë interesat e fëmijëve, së pari duke vëzhguar se cilat janë interesat që fëmijët e tyre kanë dhe së dyti duke i ekspozuar fëmijët sa më shumë me mjedise, objekte, lodra e aktivitete të reja

Trishtimi dhe zhgënjimi, shfaqen që në muajt 4-6-të të foshnjave. Fëmijët e përjetojnë trishtimin për shkak të zhgënjimeve dhe si një përgjigje ndaj ngjarjeve të jashtëzakonshme traumatike, si ndarja e gjatë me prindërit, divorci i tyre ose vdekja.

Në këto momente, prindërit empatikë ofrojnë rehati dhe ngushëllim ndaj fëmijës, si dhe i mësojnë fëmijës se ky zhgënjim, megjithëse i trishtë, nuk do zgjasë përgjithmonë. Në këtë mënyrë, fëmija zhvillon aftësinë për të *toleruar* zhgënjimin, një element thelbësor ky për aftësinë ripërtëritëse.

Përndryshe, trishtimi i zgjatur do ta orientojë fëmijën drejt të menduarit dhe drejt pritshmërive se ngjarjet në të ardhmen do të jenë zhgënjyese.



Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve

**Material konsultues me
prindërit për llojet e
emocioneve në fëmijërinë e
hershme.**


**Adresa: Rruga e Barrikadave.
Nr.tel. 042222991**



Emocionet e **turpit dhe krenarisë** shfaqen në muajt 12-18-të dhe reflektojnë drejtpërdrejt e menjëherë sensin e vetes, madje më shumë se çdo emocion tjetër, si ankthi, trishtimi apo zemërimi.

Nevoja e fëmijëve për të zbutur ndjenjën e turpit dhe mbajtja ose rekuperimi i ndjenjës së krenarisë, është një parim bazë e thelbësor për ruajtjen e shëndetit emocional.

Nevoja për të mbajtur ose restauruar ndjenjën e krenarisë është thelbësore për shëndetin mendor dhe mbetet një motivim bazë për njerëzit gjatë gjithë jetës. Përvojat që lehtësojnë ndjesitë e turpit dhe që rikthejnë ndjenjën e krenarisë, si tërheqja e vëmendjes, përkrahja e fëmijës, inkurajimi edhe pas dështimit, bëhen me shumë vlerë dhe bëhen bërthama e karakterit dhe sjelljes së fëmijëve kur të rriten.



Ankthi është pothuajse gjithmonë i pranishëm, ose lehtësisht i evokueshëm; ankthi është, së paku, një përvojë ditore në jetët e fëmijëve, ndërkohë që ata ndërmarrin veprime me prindërit, mësuesit dhe moshatarët.

Fëmijët, janë të interesuar ndaj marrëdhënieve, por dhe ankthiozë në qasjen ndaj situatave të reja, si p.sh. në ditën e parë të frekuentimit të çerdhes.

Prindërit e vëmendshëm e njohin këtë gjendje emocionale, dhe në mënyra të shumëllojshme, por në mënyrë të veçantë duke qënë të pranishëm dhe me kurajo, i ndihmojnë fëmijët t'ia dalin mbanë me ankthin duke e mbajtur në një nivel të tolerueshëm, dhe duke i lënë fëmijët të eksplorojnë e më pas të tërhiqen, e më pas përsëri të eksplorojnë.

Në këtë mënyrë, fëmijët mësojnë t'u qasen situatave të reja me interes më të madh dhe me më pak frikë.

Zemërimi që shfaqet tek foshnjat që në muajt 2-4-t evokohet nga frustrimi (interferenca me arritjen e qëllimeve të dëshiruara, vështirësia për të shkuar aty ku dëshirohet), nga të ndjerit në gabim, si dhe nga dhimbja fizike apo emocionale dhe lëndimet. Megjithëse ekzistojnë ende fakte kontroverse prej studimeve të ndryshme, shprehjet e zemërimit mund të vëzhgohen që tek foshnjat 3-4 muajshe.

Funksioni përshtatës i zemërimit është të na mbrojë ne vetë dhe ata që ne duam, p.sh. pranë familjes, fëmijët zemërohen në përgjigje të lëndimeve emocionale (sidomos ndaj kritikave dhe përjashtimit) dhe kur burimet që ata vlerësojnë nuk ndahen në mënyrë të drejtë.

Fëmijët, që në fëmijërinë e hershme, mësohen se kur dhe sa, në çfarë kushtesh dhe ndaj kujt iu lejohej ta shprehin zemërimin. P.sh. fëmijëve të moshës parashkollore iu mësohet, që në vend që të përdorin dhunën kur janë të zemëruar, të përdorin fjalët.